

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET:

KOMUNËS SË GJAKOVËS

DHE

RRJETIT TË EDUKATORËVE BASHKËMOSHATARË (PEN)

Neni 1 Përfaqësimi i palëve

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje garantojnë se ata kanë autorizimet e nevojshme për përmbushjen e obligimeve nga ky memorandum bashkëpunimi, se nënshkruesit e memorandumit të bashkëpunimit kanë zotësinë juridike për lidhje dhe nënshkrimin e së njëjtës në emër dhe për llogari të të njëjtëve, dhe se lidhja dhe përmbushja e obligimeve që dalin kjo marrëveshje është e lejuar më ligj.

Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

1. *Komuna e Gjakovës (në vijim "Komuna"), me adresë në Rr. Nëna Tereze, Gjakovë 5000, Republika e Kosovës, përfaqësohet nga Kryetari i Komunës – Ardian Gjini.*

dhe

2. *Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë – PEN (në vijim "PEN"), me adresë në Rr. Behije Dashi Nr. 5/A Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 5112039-6 si dhe numrin fiskal 600279253, përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv – Bujar Fejzullahu.*

Më tutje në tekst: PALET.

Neni 2 Qëllimet

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim të krijoj bashkëpunim në mes të Komunës dhe PEN në promovimin e gjithëpërfshirjes sociale, fuqizimin e të rinjëve, formimin e rrjeteve profesionale me të rinj dhe mbështetjen e të rinjëve në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave në komunitet.
2. Përmes këtij memorandumit të bashkëpunimit synohet realizimi i përbashkët i projektit "Social Act". Ky projekt do të realizohet përgjatë periudhës dhjetor 2018 – qershor 2019 në mënyrë të vazhdueshme dhe do të përfshijnë të rinjtë e moshë 18-25, duke i angazhuar grupet e të rinjëve më të nën-përfaqësuar dhe ata të marginalizuar, në mënyrë t'i ngrisin shkathhtësitë e tyre profesionale dhe të

kenë mbështetje në zhvillimin e ideve të ndryshme rreth projekteve sociale, iniciativave lokale dhe kampanjave të ndryshme.

3. Palët do të bashkëpunojnë rreth mundësive të inkuadrimin të rinjëve nga grupet e marginalizuara, në programe dhe projekte shtesë që zhvillojnë palët, si dhe do t'i referojnë dhe nxisin këta të rinj të aplikojnë në programet dhe projektet relevante për ta.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Palët dakordohen të bashkëpunojnë në lidhje me fushat e mëposhtme:

1. Promovimi i gjithëpërfshirjes sociale, duke u angazhuar për identifikimin e problemeve të cilat ndalojnë qasjen e barabartë në shoqëri të rinjëve të grupeve të marginalizuara.
2. Krijimin e rrjeteve të ndryshme profesionale për angazhimin e rinjëve në projekte/kampanja sociale dhe për t'i referuar ata në institucione/kompani për punësim potencial duke u bazuar në angazhimin dhe kualifikimin e tyre.
3. Informimin e rinjëve rreth politikave dhe programeve komunale, si dhe rreth problemeve kryesore të komuniteteve lokale në komunë. Poashtu krijimi i mbështetjes në komunikimin me asambleistë të komunës.
4. Angazhimi i rinjëve në trajnime për aftësimin e shkathtësive të tyre profesionale, zhvillimin e mendimit kritik, nxitjen e komunikimit aktiv, krijimin e projekteve dhe debatimit.
5. Angazhimi i rinjëve në identifikimin e problemeve në komunitete lokale dhe transformimin e tyre në projekte apo kampanja sociale që synojnë zgjidhjen e këtyre problemeve.
6. Krijimi i kanaleve efektive të komunikimit në mes komunës dhe të rinjëve të komunës.

Neni 4

Obligimet e palëve

Sipas këtij memorandumi palët pranojnë përgjegjësitë dhe obligohen si vijon:

1. Obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës përfshijnë:
 - a) Asistim në organizimin e takimit informues me të rinjtë rreth politikave, problemeve dhe programeve komunale, në koordinim me PEN.
 - b) Asistim në formimin e rrjeteve lokale me të rinjtë, përfaqësues komunal dhe asambleistë të kuvendit komunal, për angazhimin e tyre në projekte dhe iniciativa lokale.
 - c) Asistimin e rinjëve në ndjekjen e një seance në asamblenë komunale.
 - d) Asistimin e rinjëve në zhvillimin e hulumtimeve për identifikimin e problemeve kyçe në komunitete lokale.
 - e) Asistimin e PEN dhe të rinjëve në zbatimin e iniciativave lokale nga periudha janar - maj 2019.
 - f) Referimi i rinjëve në partnerë, institucione apo kompani lokale, për mundësinë e angazhimit të tyre në punë apo praktikë pune.
2. Obligimet dhe përgjegjësitë e PEN-it përfshijnë:
 - a) Mbatjen e dy trajnimeve për zhvillimin e mendimit kritik, komunikimit efektiv, debatimit, zhvillimit të projekteve, zbatimit të projekteve dhe hyrje në institucionet shtetërore.

- b) Mbikëqyrjen dhe udhëzimin e të rinjëve nga komuna përgjatë tërë angazhimit të tyre 6 mujor (dhjetor 2018 – maj 2019), duke përfshirë edhe zbatimin e iniciativave lokale.
- c) Organizimin e takimeve me komunitete lokale dhe identifikimin e të rinjëve të ri që mund t'i bashkëngjiten iniciativave lokale.
- d) Menaxhimin e fondeve përgjatë angazhimit të të rinjëve dhe për zhvillimin e zbatimit e iniciativave të tyre.
- e) Organizimin e të rinjëve në ndjekjen e një seance në asamblenë komunale.
- f) Koordinimin e të rinjëve në zhvillimin e hulumtimeve për identifikimin e problemeve kyçe në komunitete lokale.
- g) Referimi i të rinjëve në partnerë, institucione apo kompani lokale, për mundësinë e angazhimit të tyre në punë apo praktikë pune.

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm mes tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në mënyrë verbale dhe elektronike.
2. Palët do të caktojnë personat kontaktues që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informatave dhe plotësimit të kërkesave të tyre për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit.
3. Palët do të informojnë njëri-tjetrin mbi personat e kontaktit jo më vonë se dy (2) javë nga nënshkrimi i këtij Memorandumi.
4. Personat kontaktues nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikim dhe koordinim, me qëllim të dakordimit për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 6

Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Palët nënshkruese të këtij memorandumit pajtohen që ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të zgjasë për një periudhë deri në përfundim të projektit.

Neni 7

Shkëputja e Memorandumit të Bashkëpunimit

1. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të shkëputet para afatit të skadimit në marrëveshje nga të dyja palët, apo me kërkesë të njëres palë, me lajmërim paraprak me shkrim në afatin prej dy (2) javësh.
2. Ky memorandum i bashkëpunimit është i bazuar më mirëbesim dhe nuk ka për qëllim të përfitojnë palët të treta. Shkëputja mund të ndodhë në rastin nëse cila do palë është dëmtuar materialisht me veprime të qëllimshme apo nga pakujdesia e palës tjetër.
3. Kjo marrëveshje nuk parasheh implikime financiare në mes të dy palëve.

Neni 8

Gjuha e përdorur

1. Dokumenti i memorandumit të bashkëpunimit në mes Komunës dhe PEN është shkruar në gjuhën shqipe.
2. Sipas nevojave të palëve memorandumit mund të përkthehet edhe në gjuhën serbe apo angleze, me pëlqimin paraprak të palëve.


Neni 9
Hyrja në fuqi


Ky memorandum nënshkruhet me datë _____ në Gjakovë dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 10
Dispozitat kalimtare

1. Ky memorandum i bashkëpunimit rregullohet sipas dispozitave të ligjeve në fuqi në Kosovë.
2. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e palëve, dhe kërkesa për modifikim duhet të dorëzohet te pala tjetër së paku dy (2) javë para datës së synuar të modifikimit.
3. Ky memorandum i bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën prej palëve.

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN)


Drejtori Ekzekutiv
Bujar Fejzullahu
Prishtinë, me: 5/12/2018



Komuna e Gjakovës


Kryetari i Komunës
Ardian Gjini
Gjakovë, me: 5/12/2018

